



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2023-10

**Prokurorja e Specializuar k. Sabit Januzit, Ismet Bahtijarit dhe
Haxhi Shalës**

Vendosi: Gjykatësi i Procedurës Paraprake

Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 19 prill 2024

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Vendim mbi Kërkesën e Dytë për Zgjatje të Afatit

Prokurores së Specializuar
Kimbërli P. Uest

Mbrojtjes së Sabit Januzit
Xhonatan Elistan Ris
Hju Bauden

Mbrojtjes së Ismet Bahtijarit
Felisiti Geri
Xhejms O'Kif

Mbrojtjes së Haxhi Shalës
Tobi Kadman
Xhon Kabën

GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE,¹ në bazë të rregullave 9(5)(a) dhe 76 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja") lëshon këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL DHE PARASHTRIMET

1. Më 19 prill 2024, Mbrojtja e Ismet Bahtijarit ("z. Bahtijari" dhe "Mbrojtja") paraqiti një kërkesë me të cilën kërkonte zgjatjen e mëtejshme të afatit për plotësimin dhe dorëzimin e formularëve, ndër të cilët dokumentacionin mbështetës që duhej për t'i kërkuar ndihmë juridike Zyrës Administrative ("Kërkesa").²

2. Më të njëjtën ditë, Mbrojtja dorëzoi kërkesën e ndryshuar ("Kërkesa e Ndryshuar").³

II. DISPOZITAT LIGJORE PÛRKATËSE

3. Sipas rregullës 9(5)(a) të Rregullores, nëse tregohen arsye të vlefshme, ose *proprio motu*, paneli mund të zgjasë ose të shkurtojë afatet e përcaktuara prej kësaj Rregulloreje apo prej panelit.

4. Sipas rregullës 76 të Rregullores, kërkesat për zgjatje të afatit paraqiten në kohë, për t'i lënë panelit kohë të mjaftueshme për marrjen e vendimit në lidhje me kërkesën para përfundimit të afatit përkatës.

¹ KSC-BC-2023-10, F00001, Kryetarja, *Vendim për Caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 11 shtator 2023, publik. KSC-BC-2023-11, F00001, Kryetarja, *Vendim për Caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 20 nëntor 2023, publik.

² KSC-BC-2023-10, F00255, Mbrojtja, *Parashtrim i Bahtijarit për Zgjatje të Mëtejshme të Afatit për Ndihmën Juridike*, 19 prill 2024, konfidencial.

³ KSC-BC-2023-10, F00256, Mbrojtja, *Parashtrim i Ndryshuar i Bahtijarit për Zgjatje të Mëtejshme të Afatit për Ndihmën Juridike*, 19 prill 2024, konfidencial.

III. DISKUTIM

5. Fillimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vë në dukje se Mbrojtja e dorëzoi Kërkesën e Ndryshuar pothuajse brenda një ore pas Kërkesës,⁴ në ditën e fundit të afatit përkatës, d.m.th. të premten, më 19 prill 2024.⁵

6. Trupi Gjykues thekson se Kërkesa e Ndryshuar ndryshon prej Kërkesës pasi Mbrojtja: (i) i vënë vijë një rreshti në parashtrimet e veta, me sa duket për të treguar se dokumenti i përmendur aty nuk ka nevojë të shqyrtohet; dhe (ii) përfshiu një parashtrim të ri që i referohet një dokumenti të ri, i cili, sipas Mbrojtjes, duhet të shqyrtohet.⁶ Meqë Kërkesa e Ndryshuar duket se përmban zhvillimet më të fundit, në vijim, Gjykatësi i Procedurës Paraprake do të shqyrtojë vetëm Kërkesën e Ndryshuar. Gjykatësi i Procedurës Paraprake i kërkon Mbrojtjes që në të ardhmen të sigurojë që parashtrimet e protokolluara të saj të paraqiten qartë në mënyrë që të parandalohet çdo paqartësi dhe, në qoftë se është e zbatueshme, të njoftojë menjëherë kur një parashtrim i protokolluar nuk duhet të përpunohet nga Njësia për Administrimin e Gjykatës për të lehtësuar përpunimin dhe shpërndarjen e parashtrimeve të protokolluara.

7. Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjithashtu rithekson për Mbrojtjen se, në përputhje me rregullën 76 të Rregullores, kërkesat për zgjatje të afatit paraqiten në kohë, për t'i lënë panelit kohë të mjaftueshme për marrjen e vendimit në lidhje me kërkesën para përfundimit të afatit përkatës. Sidoqoftë, duke pasur parasysh rëndësinë e situatës së financimit,⁷ Gjykatësi i Procedurës Paraprake pranon ta shqyrtojë Kërkesën e Ndryshuar për arsye të jashtëzakonshme.

⁴ Gjykatësi i Procedurës Paraprake thekson se Kërkesa u dorëzua në orën 05:49 dhe Kërkesa e Ndryshuar u dorëzua në orën 06:58.

⁵ KSC-BC-2023-10, F00233, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën për Zgjatje të Afatit*, 15 prill 2024, publik, para. 6.

⁶ *Krahaso* Kërkesën, para. 3 *me* Kërkesën e Ndryshuar, para. 3-4.

⁷ *Shih* KSC-BC-2023-10, F00253, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim që Përcakton Kalendarin për Hapat e Mbetur Proceduralë të Fazës së Procedurës Paraprake*, 27 mars 2024, publik, para. 14.

8. Sa u përket arsyeve të vlefshme, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vë në dukje se, që nga parashtrimet e fundit mbi këtë aspekt,⁸ Mbrojtja ka përparuar në përgatitjen e kërkesës për t'i kërkuar ndihmë juridike Zyrës Administrative. Gjykatësi i Procedurës Paraprake në veçanti thekson se: (i) z. Bahtijari ka dorëzuar të gjitha dokumentet relevante për paraqitjen e kërkesës së Mbrojtjes për ndihmë juridike; dhe (ii) janë marrë disa dokumente mbështetëse që mungonin.⁹ Gjithashtu, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mban parasysh faktin se: (i) një dokument mbështetës që mungon duhet të jetë i disponueshëm javën e ardhshme; dhe (ii) dokumentacioni tjetër mbështetës është kërkuar, por Mbrojtja e z. Bahtijari nuk e ka marrë ende.¹⁰ Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se janë paraqitur arsye të vlefshme që përligjin zgjatjen e kërkuar të afatit.

IV. VENDIM

9. Bazuar në arsyet e lartpërmendura, Gjykatësi i Procedurës Paraprake:

- a) **MIRATON** Kërkesën e Ndryshuar;
- b) **URDHËRON** Mbrojtjen të plotësojë dhe t'ia dorëzojë kërkesën me të cilën kërkon ndihmë juridike Zyrës Administrative, si dhe të informojë Gjykatësin e Procedurës Paraprake lidhur me të, deri të **hënën, 29 prill 2024**; dhe
- c) **URDHËRON** Mbrojtjen të dorëzojë versionin e redaktuar të Kërkesës së Ndryshuar, deri të **hënën, 29 prill 2024**.

/nënshkrimi/

⁸ *Shih* KSC-BC-2023-10, F00250, Mbrojtja, *Parashtrim i Bahtijarit për Zgjatje të Afatit për Ndihmën Juridike*, 12 prill 2024, publik.

⁹ Kërkesa e Ndryshuar, para. 2-3.

¹⁰ Kërkesa e Ndryshuar, para. 4-6.

Gjykatës Nikola Giju
Gjykatës i Procedurës Paraprake

E premte, 19 prill 2024
Në Hagë, Holandë.